



Ofertë referencë

Interkoneksioni për terminimin e thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale

IPKO Telecommunications LLC

për

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve publike

Version 2.0

SHKURT 2022



PËRMBAJTJA

- Neni 1.....Objekti
- Neni 2.....Korniza Ligjore
- Neni 3.....Parimet e përgjithshme dhe kufizimet e ofertës referencë
- Neni 4.....Qasja në dokumentacion dhe informata
- Neni 5.....Përkufizime dhe shkurtesa
- Neni 6.....Interkoneksioni i rrjetit të sistemit të IPKO-s me sistemin e operatorit përfitues
- Neni 7.....Ofrimi i interkoneksionit të rrjetit
- Neni 8.....Shërbimet në interkoneksionin e rrjetit
- Neni 9.....Parashikimi i trafikut dhe kërkesat për shërbimet e interkoneksionit të rrjetit
- Neni 10.....Çmimet dhe faturimi
- Neni 11.....Matja dhe faturimi i trafikut
- Neni 12.....Pezullimi i përcjelljes së raportit mbi thirrjet
- Neni 13.....Faturimi i trafikut që rrjedh nga interkoneksioni i rrjetit
- Neni 14.....Numeracioni, rutimi i trafikut dhe prezantimi i numrave
- Neni 15.....Paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse (CLI)
- Neni 16.....Cilësia e shërbimit
- Neni 17.....Përmirësimi i gabimeve
- Neni 18.....Përshkrimi i rrjetit dhe ndërhyrjet – standardet dhe kërkesat teknike
- Neni 19.....Normat dhe bashkëpunimi operativ
- Neni 20.....Procedurat e porositjes dhe njoftimit
- Neni 21.....Sanksionet për shkeljet e kushteve dhe përsjashtimi e kufizimi i përgjegjësisë
- Neni 22.....Rregullat e procedurës së kontratës
- Neni 23.....Sigurimi i përgjegjësive
- Neni 24.....Periudha e vlefshmërisë dhe tërheqja nga marrëveshjet
- Neni 25.....Fillimi i vlefshmërisë dhe modifikimet e ofertës referencë
- Neni 26.....Mbrojtja e informacionit konfidencial
- Neni 27.....Procedurat
- Neni 28.....Zgjidhja e kontesteve
- Neni 29.....Trashëgimia juridike

LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1.....Pika e lidhjeve
- Shtojca 2.....Skema e pikës së lidhjes
- Shtojca 3.....Interkoneksioni i rrjetit duke marrë parasysh vendndodhjen e pikës të operatorit përfitues dhe sistemit të IPKO-s
- Shtojca 4.....Çmimet e shërbimeve
- Shtojca 5.....Kërkesa standarde
- Shtojca 6.....Formulari i garancisë

VËREJTJE 1, 2, 3, 4



Neni 1 Objekti

1. Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i elementeve dhe kushteve thelbësore si dhe i procedurave që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet IPKO-s dhe operatorit përfitues për interkoneksionin e rrjetit për terminimin e thirrjes me zë në rrjetet mobile individuale që kushtëzohen me përmbylljen e marrëveshjes me shkrim, përmes së cilës do të përcaktohen edhe elementet dytësore në pajtim me dispozitat e kësaj oferte referencë.

2. Objekti i kësaj oferte referencë është ofrimi i shërbimeve nga IPKO në pikën e interkoneksionit me qëllim të përdorimit të tyre nga operatorët përfitues. Kjo ofertë referencë publikohet në ueb faqen e IPKO-s dhe iu drejtohet të gjithë operatorëve përfitues për të realizuar terminimin e thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale dhe për qëllim që t'i kryejnë ato nëpërmjet interkoneksionit sipas Licencës/Autorizimit nga ARKEP dhe marrëveshjes së lidhur me IPKO-n duke u mbështetur në një marrëveshje paraprake për mos-zbulim të informatave.

3. Oferta referencë përcakton mënyrën e kryerjes së terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale dhe shërbimet që ua ofron IPKO operatorëve përfitues nëpërmjet këtyre interkoneksioneve të rrjetit, dhe rregullon kushtet themelore të marrëdhënies ndërmjet IPKO-s dhe operatorit përfitues. Oferta përcakton shërbimet themelore të interkoneksionit të rrjetit vetëm për terminimin e thirrjes me zë në rrjetet mobile individuale:

3.1 Interkoneksionin e rrjetit të sistemit të IPKO-s me sistemin e operatorëve përfitues:

- linjat e sinjalit, funksionet e sinjalit dhe trafikun e sinjalit;
- testimin nga rrjeti i interkoneksionit të çdo ndërlidhje;
- vendosjen e rutimit të thirrjeve në rrjetin e operatorit përfitues në qendrat e ndërrimit të IPKO dhe anasjelltas;
- ndryshimi i parametrave të çdo kapaciteti, që përfshin parametra të tilla si CRC₄, sinkronizimi i kanalit, sinjali i kanalit, etj.

3.2 Shërbimet themelore telefonike të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

3.3 Linja për qëllim të interkoneksionit të rrjetit definohej si linja për qëllim të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale dhe do të përcaktohen në bazë të marrëveshjes me shkrim, parakusht për këtë ofertë dhe sigurohen në përputhje me:

ITU-T G.703: Karakteristikat fizike / elektrike të interfejsit hierarkik digjital ITU- T G.707: Interfejsi i njëjës së rrjetit për hierarkinë digjitale të sinkronizuar (SDH) ITU- T G.781: Struktura e rekomandimeve lidhur me pajisjet për hierarkinë digjitale të sinkronizuar (SDH) ITU-T G.782: Llojet dhe karakteristikat e hierarkisë digjitale të sinkronizuar (SDH) Pajisje ITU-T G.783: Karakteristikat e hierarkisë digjitale të sinkronizuar (SDH) Blloqet funksionale të pajisjeve ITU-T G.803: Arkitektura e rrjeteve të transportit bazuar në hierarkinë digjitale të sinkronizuar (SDH)..

4. Bazuar në vendimin të ARKEP-it nr. 1643, thirrjet me origjinë jashtë Kosovës dhe/ose terminimi në lokacion fiks nuk janë objekt i kësaj oferte. Të gjitha marrëdhëniet tjera të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ofertë referente do të rregullohen me një marrëveshje me shkrim.



Neni 2

Korniza ligjore

1. IPKO Telecommunications LLC (në tekstin e mëtejshëm: IPKO) e publikon këtë ofertë referencë për interkoneksionin e rrjetit për terminimin e thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike të shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës më 09 nëntor 2012, Rregulloren nr. 28 për analizat e tregut dhe përcaktimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg (nr. prot. 012/B/11), Rregulloren për Sigurimin e Qasjes (nr. prot. 012/B/11), Rregulloren e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (në tekstin e mëtejshëm ARKEP) për analizat e tregut dhe përcaktimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg, nr. prot. 115/1/10, të datës 20 dhjetor 2010, Rregulloren mbi interkoneksion me nr. prot. 012/B/11, të 3 qershorit 2011 dhe Vendimin 1643 për përcaktimin e IPKO Telecommunications LLC si operator me fuqi të ndjeshme në tregun e terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

Neni 3

Parimet e përgjithshme dhe kufizimet e ofertës referencë

1. Kjo ofertë nuk përfshin transferimin e të drejtave të pronësisë ose pronësisë intelektuale, ose përdorimin e tyre. Ajo gjithashtu nuk përfshin asnjë transferim të "know-how".

2. IPKO mund të refuzojë nënshkrimin e marrëveshjes në rastet:

- ku sipas ligjit nuk është e nevojshme të veprojë ashtu;
- nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e përshkruara në ndonjë nen të kësaj oferte;
- mbi bazën e kriterëve objektive:
 - kur realizueshmëria teknike nuk është e mundur;
 - për shkak të nevojës për të ruajtur integritetin e rrjetit si p.sh. rruajtja e sigurisë së të dhënave, evitimi nga mashtrimi, mbrojtja e mjedisit, etj.;
 - për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë ofertë referuese p.sh. paradhënia e kërkuar, fondet e pamjaftueshme, mungesa e garancisë bankare, mospagesa e depozitës ose paaftësia për të paguar (insolvenca), etj.;
 - për shkak të shkeljes së deklaratës;
 - për shkak të zbulimit të sekretit afarist;
 - për çfarëdo arsye tjetër të paraparë me ligjin e zbatueshëm.

Neni 4

Qasja në dokumente dhe informata

1. Të gjithë operatorët e interesuar përfitues duhet të adresojnë kërkesat e tyre për çdo dokumentacion të përmendur në ofertë referente për interkoneksionin e rrjetit për terminimin e thirrjeve me zë në rrjete mobile individuale në formë të shkruar në adresën e mëposhtme:

IPKO Telecommunications LLC
Departamenti Ligjor
Rruga "Zija Shemsiu", nr. 34, Prishtinë
10000, Kosovë
Telefoni: +383 49 700 700



IPKO do të dërgojë dokumentet për operatorin përfitues, pasi operatori i interesuar përfitues të nënshkruan një marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e sekretit tregtar. Çdo kërkesë për informacion në lidhje me ofertën referente për interkoneksion të rrjetit për terminim të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale duhet të adresohet me shkrim në adresën e lartpërmendur. IPKO ruan të drejtën për të refuzuar të gjitha kërkesat në rastet kur palët e interesuara nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe kushtet në përputhje me këtë ofertë referente dhe rregullave të brendshme të IPKO-s. Në këto raste, IPKO do të përgjigjet me shkrim dhe kopje do të dërgohen edhe pranë ARKEP-it.

Neni 5

Përkufizime dhe shkurtesa

ARKEP - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi i pavarur rregullator i autorizuar për të zbatuar politikën e Qeverisë së Kosovës dhe të ministrive në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike dhe të gjithë ligjet tjera zbatueshme.

CRC₄ - (Cyclic Redundancy Check ₄) formë e kontrollimit ₄ të ciklit të gabimeve – një metodë e kontrollimit të gabimeve në të dhënat e transmetuara.

CLI – Calling Line Identification (Identifikimi i linjës së thirrjes).

Ditë pune – Nga e hëna deri të premten përveç festave zyrtare të Kosovës.

ETS – Standardet Evropiane të Telekomunikacionit.

ETSI – Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit.

E₁ – në telekomunikimin digjital, ku një tel i vetëm mund të përdoret për mbajtjen/transmetimin simultant të disa bisedave me zë me ndarje multiplekse-kohore.

IPKO – Kompania "IPKO Telecommunications LLC".

Parapaguesi A – Pala që thërret e identifikuar nga numri i përdoruesit përfundimtar.

Informacioni i faturimit – është informacion në lidhje me thirrjet e bëra nga konsumatorët gjatë periudhës përkatëse të faturimit: (numri i telefonit të një parapaguesi A, numri i telefonit i parapaguesit B, kohëzgjatja e thirrjes në minuta dhe sekonda në mes përgjigjes së B dhe terminimit të thirrjes; data dhe koha e përgjigjes të B dhe në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve, çdo tarifë e veçantë që vlen për thirrje.

Informata konfidenciale - Të gjitha dokumentet dhe informatat tjera, qoftë teknike ose komerciale, në lidhje me projektimin, rehabilitimin, sigurimin, operimin, mirëmbajtjen, menaxhimin dhe financimin e operacioneve të shërbimeve të telekomunikacionit apo çfarëdo aktiviteti, objekti lidhur me këtë, por duke mos përfshirë asnjë informacion tashmë në domenin publik përveç shkeljeve të detyrimeve të përfshira në Ligj ose ligjeve dhe rregulloreve tjera në fuqi.

ISDN – shërbime të integruara rrjet digjital (Integrated services digital network).

ISUP – ISDN pjesa përdoruese (ISDN user part).



MTP – Protokoll i transferit të të dhënave (Media Transfer Protocol).

ITU – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.

IT – Teknologji informative (Information Technology).

IPKO Sistemi – në këtë ofertë do të thotë vetëm rrjeti mobil i IPKO-s në pronësi dhe i menaxhuar nga IPKO në territorin e Republikës së Kosovës.

Kapaciteti i interkoneksionit - është kapaciteti (lidhjet E1) i qendrës së ndërrimit të IPKO-s në pikën e lidhjes.

MTP – Protokoll i transferimit të medias.

MS – milisekond.

MGW – Media gateway – pajisje për transformimin e medias digjitale midis rrjeteve të ndryshme të telekomunikacionit siç janë PSTN dhe SS7.

Terminimi i thirrjes – Terminimi i lidhjes midis një parapaguesit A dhe parapaguesit B.

Interkoneksion - lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimeve të përdorura nga e njëjta ose një ndërmarrje tjetër në mënyrë që të lejojë përdoruesit e një ndërmarrjeje për të komunikuar me përdoruesit e të njëjtës ose një ndërmarrje tjetër, apo të qasen në shërbimet e ofruara nga një ndërmarrje tjetër. Interkoneksioni është një lloj specifik i qasjes

OSI – Sistemi i hapur i interkoneksionit.

Operator përfitues - është operatori i një rrjete publike të telekomunikimit apo shërbimeve të telekomunikimit, i cili ka aplikuar me shkrim për të marrë interkoneksionin.

Operatori - një ndërmarrje që siguron ose është e autorizuar për të siguruar një rrjet publik të telekomunikacionit apo një strukturë të lidhur.

Operatori i detyruar - është një operator telekomunikacioni, i cili sipas procedurave, të përcaktuara me akte ligjore, është i detyruar të ofrojë interkoneksion.

Oferta Referencë - kushtet e bëra publike nga një operator, sipas të cilës ai bën një zotim për të ofruar qasje në çdo ndërmarrësi e cila kërkon një qasje të tillë.

POC – Pika e lidhjes (Point of connection).

Parapaguesi A – Pala që thërret e identifikuar nga numri i përdoruesit përfundimtar.

Përgjigja B – Një sinjal i kthyer mbi një qark të transmetimit të interkoneksionit, sinjali duke u kthyer nga terminali pranues për të treguar se B-parapaguesi i është përgjigjur thirrjes.



Parapaguesi B – pala e thirrur nga parapaguesi A dhe e identifikuar nga numri i përdoruesit të fundit me një prej palëve.

Pika e interkoneksionit – Një pikë fizike e pranisë në rrjetin e IPKO-s e cila lejon shkëmbimin e interkoneksionit.

PSTN - Komutuesi publik i rrjetit të telefonisë.

Rregullore – Të gjitha aktet nënligjore të Republikës së Kosovës në fuqi, akt nënligjor i ARKEP-it, ETI dhe ITU-se etj.

SS7 – Sistemi sinjalizimit 7.

SP – Pika sinjalizuese.

STP – Pika sinjalizuese transferuese.

TVSH – Tatimi mbi vlerën e shtuar sipas ligjit të Republikës së Kosovës.

Testim- të gjitha punët fizike dhe logjike për dhe lidhur me punën e testimit të pajisjeve harduerike dhe softuerike të interkoneksionit, por duke mos u kufizuar vetëm në këtë.

Termet tjera që nuk janë përkufizuar drejtpërdrejt në këtë ofertë, por janë të përkufizuara në aktin ose aktet ekzekutive, përdoren siç përkufizohen në aktin apo aktet ekzekutive të cilave kjo ofertë iu referohet.

Neni 6

Interkoneksioni i rrjetit të sistemit të IPKO-s me sistemin e operatorit përfitues

1. Baza për lidhjen e IPKO-s me operatorin përfitues është në përputhje me dispozitat e kësaj oferte referencë dhe shtojcat për kryerjen e shërbimeve. Zbatimi dhe ofrimi i interkoneksionit të rrjetit të IPKO-s dhe sistemit të operatorit përfitues përfshin shërbimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe mënyra e interkoneksionit të rrjetit do të përcaktohet në bazë të marrëveshjes me shkrim ndërmjet IPKO-s dhe operatorit përfitues në bazë të shtojcave të kësaj oferte referencë.

2. Sistemi i IPKO-s dhe sistemi i operatorit përfitues do të lidhen në përputhje me shtojcat e kësaj oferte dhe marrëveshjes me shkrim që do të arrihet ndërmjet IPKO-s dhe operatorit përfitues. IPKO dhe operatori përfitues do të testojnë funksionimin e interkoneksionit të rrjetit në përputhje me rekomandimet e ITU-T-së. Pasi që testimi të përfundohet, IPKO dhe operatori përfitues do të sigurojnë mbështetjen e duhur profesionale për eliminimin e gabimeve që mund të shfaqen brenda periudhës së ardhshme prej 3 (tre) muajsh. Sinkronizimi i sistemit të operatorit përfitues në sistemin e IPKO-s kryhet në bazë të parimit "pronar - skllav" me nxjerrjen e normës nga një lidhje 2 Mbps në përputhje me rekomandimet e ITU-T-së.

Neni 7

Ofrimi i interkoneksionit të rrjetit



1. Vendosja e dimensioneve dhe pagesa e linjave të interkoneksionit dhe linjave të sinjalit të siguruara nga IPKO është përgjegjësi e operatorit përfitues, nëse nuk shprehet ndryshe në këtë ofertë

referencë. Implementimi i interkoneksionit të rrjetit përfshin kryerjen e interkoneksionit të rrjetit dhe testimin e suksesshëm.

2. Afati i fundit për implementimin e interkoneksionit të rrjetit fillon nga data kur nënshkruhet marrëveshja në mënyrë të vlefshme, nëse operatori përfitues i përmbahet detyrimeve kontraktuale. Nëse IPKO zbulon se numri i linjave të ndërlidhura, të kapaciteteve apo linjave të sinjalit është shumë i vogël, do të njoftojë operatorin përfitues. Në rast se operatori përfitues nuk lëshon urdhrin brenda 15 ditëve, IPKO do të njoftojë ARKEP-in.

3. IPKO ofron një konfigurim bazë për shërbimet e interkoneksionit të rrjetit, i cili mundëson trafikun në të dy drejtimet (kapacitetet e dyanshme). IPKO gjithashtu ofron trafikun vetëm në një drejtim (kapaciteti në një drejtim). IPKO dhe operatorit përfitues në rastin e trafikut të paekuilibruar do të bien dakord të zbatojnë kapacitetet njëdrejtimëshe për një apo drejtimin tjetër.

4. Konsiderohet se trafiku në interkoneksion është i balancuar deri sa bilanci i trafikut nga të dy drejtimet nuk ndërhyt me funksionimin e duhur të pajisjeve të operatorit, dhe derisa nuk ka tregues për ndalimin e trafikut në çdo tre muaj rresht. Raporti i shtypjes dhe ndarjes së kostove do të përfundohet pas bisedimeve me një marrëveshje me shkrim nëpërmjet së cilës qasja 2Mbps është e lidhur dhe nëpërmjet të cilës kryhet shërbimi në vijim:

- Terminimi i thirrjeve nga telefonia mobile kombëtare të përdoruesve fundor nga sistemi i operatorit përfitues të përdoruesit fundor në sistemin IPKO-s.

Neni 8

Shërbimet në interkoneksionin e rrjetit

1. Shërbimi përfshin vetëm terminimin e thirrjeve të përdoruesve fundor nga sistemi i operatorit përfitues të përdoruesit fundor të sistemit të IPKO-s. Thirrjet e përdoruesve fundor me origjinë në sistemin e operatorit përfitues, të përcjella nga operatorit përfitues, terminohen nëpërmjet interkoneksionit të rrjetit të përdoruesit fundor në rrjetin e IPKO-s mbi numrat jo-gjeografik, të caktuar nga ARKEP-i, në përputhje me Rregulloren mbi planin e numeracionit për rrjetet e telekomunikacionit në Republikën e Kosovës.

2. IPKO do t'i faturojë operatorit përfitues çmimin për një minutë të kohës së thirrjes së faturuar për terminimin në rrjetin e IPKO-s, kur ajo është realizuar mbi interkoneksionin e rrjetit dhe varet nga mënyra e kryerjes së interkoneksionit të rrjetit. Intervali i faturimit është një sekondë. Çmimet e shërbimeve janë të përcaktuara në shtojcën 4 paragrafi 6 të kësaj oferte referencë.

Neni 9

Parashikimi i trafikut dhe kërkesat për shërbimet e interkoneksionit të rrjetit

1. Deri më 1 tetor të çdo viti, operatorit përfitues do të paraqes një plan të përafërt vjetore të kërkesës së tyre për linjat e sinjalit dhe linjat e interkoneksionit të rrjetit për vitin e ardhshëm, duke përfshirë një



plan të vëllimeve të trafikut (nëse ka nevojë, trafiku i planifikuar duhet të jetë i ndarë në kategori të intensitetit më të vogël dhe të madh, dhe në bazë të pikave të ndryshme të interkoneksionit të rrjetit).

2. Me kërkesë të IPKO-s, operatori përfitues do të sigurojë informacione shtesë që janë të nevojshme për përgatitjen e një plani vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni dhe anasjelltas.

Neni 10

Çmimet dhe faturimi

1. Kjo ofertë referencë përmban çmimet e shërbimeve të interkoneksionit të rrjetit që IPKO i ofron operatorit përfitues, pasi që ato do të përcaktohen në bazë të këtij kapitulli, në shtojcat e kësaj oferte referencë.

2. Çmimet e ofertës referencë janë të shënuara në shtojcat e kësaj oferte referencë. Çmimet e shërbimeve të tjera të IPKO-s përcaktohen në marrëveshje në përputhje me shërbimet e brendshme elektronike të komunikimit dhe aktet tjera të përgjithshme të IPKO-s. IPKO do të njoftojë operatorin përfitues për çdo ndryshim të çmimeve në një notë me shkrim, nëse është e mundur, së paku tridhjetë (30) ditë para se ndryshimet të hyjnë në fuqi, ose sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Pagesat duhet të paguhen 15 ditë nga data kur është lëshuar fatura. Në rast të pagesave të vonuara, pala që ka lëshuar faturë në bazë të marrëveshjes me shkrim do të ngarkojë palën tjetër me kamatë ligjore për vonesë për çdo ditë vonese të pagesës. Kjo normë interesi do të jetë objekt i një marrëveshjeje, të nënshkruar pas bisedimeve.

Neni 11

Matja dhe faturimi i trafikut

1. Matja e trafikut mujor fillon kur ai aktivizohet, dhe në ditën e parë të muajit në orën 00:00, dhe përfundon në ditën e fundit të muajit në orën 24:00. Kur faturimi i trafikut ka filluar në ditën e fundit të muajit dhe përfundon në ditën e parë të muajit në vijim, matja e trafikut do të bazohet në fillimin dhe kohëzgjatjen e thirrjes dhe do të faturohet në muajin kur thirrja ka filluar.

2. IPKO dhe operatori përfitues do të shkëmbejnë raportet për matjen e trafikut. Këto raporte do të përfshijnë të gjitha të dhënat në të cilat faturat e përmendura në shtojcat e kësaj oferte referencë.

3. IPKO do të përgatisë një raport për:

- Të gjitha thirrjet nga sistemi IPKO në sistemin e operatorit përfitues, të klasifikuara sipas llojeve të trafikut.
- Të gjitha thirrjet nga sistemi i operatorit përfitues në sistemin IPKO, të klasifikuar sipas llojeve të trafikut.

4. Operatori përfitues do të përgatisë një raport për:

- Të gjitha thirrjet nga sistemi i operatorit përfitues në sistemin IPKO, të klasifikuar sipas llojeve të trafikut.
- Të gjitha thirrjet nga sistemi IPKO në sistemin e operatorit përfitues, të klasifikuara sipas llojeve të trafikut.



5. Modeli i raportit do të specifikohet në marrëveshjen që do të arrihet me shkrim. IPKO dhe operatori përfitues do të shkëmbejnë raportet mbi trafikun e përbashkët deri në ora 12 në ditën e tetë të muajit, përkatësisht: IPKO do të përcjell të dhënat te operatori përfitues në adresën e dhënë, dhe operatori përfitues do të përcjell të dhënat e tij të IPKO në adresën e dhënë në këtë oferte. Raportet po ashtu duhet të dërgohet me postë rekomande. IPKO dhe operatori përfitues duhet të konfirmojnë të gjitha të dhënat dhe t'i dërgojnë ato në adresat e mësipërme deri në orën 12 në ditën e dhjetë të muajit. Mos konfirmimi i këtyre të dhënave nuk e shtyn lëshimin e faturës.

6. Nëse mospërputhja me llojet e ndryshme të trafikut është më pak se 2% asnjëri klient nuk do të ketë të drejtë ankese. Nëse mospërputhjet tejkalojnë 2%, pjesa e faturës që është përtej mosmarrëveshjes do të paguhet. Për të përcaktuar diferencën, një kërkesë duhet t'i paraqitet operatorit përfitues. Në kërkesën e dërguar pala duhet të specifikojë arsyen për kërkesën dhe të paraqesë provat ekzistuese. Palët kontraktuese do të kërkojnë menjëherë për të zgjidhur mospërputhjen me pëlqimin e përbashkët dhe pasi të jenë shterur të gjitha rrugët dypalëshe të vendosjes të mospërputhjes, palët mund të iniciojnë veprime ligjore.

7. IPKO dhe operatori përfitues duhet të mbajnë të dhënat e trafikut të përbashkët në përputhje me kufizimet e vëna nga legjislacioni në fuqi, për qëllime të faturimit të ndërsjellë. Të dhënat duhet, për kohën e lejuar nga ligji në fuqi, të përfshijnë të dhëna për të gjitha thirrjet individuale me të paktën të dhënat e mëposhtme për çdo thirrje:

- Numri A;
- Numri B;
- Koha e fillimit të thirrjes sipas kohës lokale;
- Kohëzgjatja e thirrjes në sekonda.

Neni 12

Pezullimi i përcjelljes së raportit mbi thirrjet

Nëse IPKO ose operatori përfitues nuk i përcjellin palës tjetër të dhënat e përcaktuara në nenin 13 me kohë, pala tjetër nuk është përgjegjëse për pagesën e faturës së lëshuar.

Neni 13

Faturimi i trafikut që rrjedh nga interkoneksioni i rrjetit

1. Bazuar në matjet veta, IPKO do t'i lëshojë operatorit përfitues një faturë për të gjitha thirrjet e ngarkuara nga IPKO për operatorin përfitues të cilat janë bërë nëpërmjet interkoneksionit të rrjetit dhe që rregullohen me një marrëveshje me shkrim të interkoneksionit të rrjetit të nënshkruar me operatorin përfitues, deri me ditën e pesëmbëdhjetë të muajit për muajin paraprak.

2. Fatura, përveç kërkesave ligjore për formën e faturës, duhet të tregojë gjithashtu si në vijim, të ndara sipas llojeve të trafikut:

- Numrin e thirrjeve;
- Kohëzgjatjen e të gjitha thirrjeve të faturuara në sekonda, të rrumbullakuar në minutën



- më të përafërt të plotë dhe të treguar në minuta në faturë;
- Çmimet sipas shërbimeve me dhe pa TVSH;
- Shumën totale me dhe pa TVSH;
- Valutën.

Faturimi i trafikut që rrjedh nga ndërlidhja e rrjetit është një produkt i kohëzgjatjes së thirrjeve të faturuara dhe tarifës të përcaktuar në ofertën referencë dhe/ose në marrëveshjen me shkrim.

3. Bazuar në matjet e veta, operatori përfitues do t'i lëshojë IPKO-s një faturë për të gjitha thirrjet e ngarkuara nga operatori përfitues për IPKO-n të cilat janë bërë nëpërmjet interkoneksionit të rrjetit dhe që rregullohen me një marrëveshje të interkoneksionit të rrjetit të nënshkruar me IPKO-n, deri me ditën e pesëmbëdhjetë të muajit për muajin paraprak.

Fatura, përveç kërkesave ligjore për formën e faturës, duhet të tregojë gjithashtu si në vijim, të ndara sipas llojeve të trafikut:

- Numrin e thirrjeve;
- Kohëzgjatjen e të gjitha thirrjeve të faturuara në sekonda, të rrumbullkuara në minutën më të përafërt të plotë dhe të treguar në minuta në faturë;
- Çmimet sipas shërbimeve me dhe pa TVSH;
- Shumën totale me dhe pa TVSH;
- Valutën.

Faturimi i trafikut që rrjedh nga ndërlidhja e rrjetit është një produkt i kohëzgjatjes së thirrjeve të faturuara dhe tarifës të përcaktuar në ofertën referencë dhe/ose në marrëveshjen me shkrim.

Neni 14

Numeracioni, rutimi i trafikut dhe prezantimi i numrave

1. Në sistemin e tij, operatori përfitues do të përdorë blloqe të numrave, të përcaktuara nga ARKEP-i, në përputhje me Rregulloren për Planin Kombëtar të Numeracionit. Të dyja palët janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën për të gjitha llojet e ndryshimeve të numrave kombëtarë dhe grupeve të tjera të numrave të përdorura në sistemet e tyre.

2. Palët do të krijojnë ndryshimet e nevojshme në sistemet e tyre për rutim në mes të sistemeve të tyre.

3. Në bazë të kësaj oferte dhe marrëveshjes, që do të lidhet, të dyja palët rregullojnë edhe më për së afërmi sigurimin e një prezantimi të CLI.

4. IPKO dhe operatori përfitues reciprokisht do të sigurojnë një transmetim transparent të thirrjeve pa manipulime apo kufizime nga prezantimi i numrave CLI në mes burimit dhe rrjetit terminal.

4.1 Sigurimi i transparencës CLI përmes rrjeteve rregullohet si më poshtë:

- IPKO dhe operatori përfitues marrin përsipër që të përcjellin në mënyrë transparente të gjitha thirrjet kombëtare me CLI me origjinë nga operatori përfitues në rrjetin kombëtar.

4.2 Transparenca CLI nëpërmjet rrjeteve kërkon:



- CLI (nga numri thirrës) transferimin në rrjetet e terminimit;
- Transferimin e parametrave CLI (të tilla si CLIP dhe CLIR) nga rrjeti burimor në rrjetin e terminimit.

4.3 Nëse operatori përfitues nuk arrin që të dërgojë numrin thirrës A në sistemin e IPKO-s, IPKO do të refuzojë thirrjet e tilla.

Neni 15

Identifikimi i linjës thirrëse (CLI)

1. Në momentin kur njëra Palë përcjell thirrjet në rrjetin e Palës tjetër, është e detyruar të transmetojë Identitetin e Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur atë, duke përdorur protokollin e sinjalizimit të përshkruar në këtë ofertë referente dhe në marrëveshjen me shkrim, CLI duhet që gjithmonë të paraqesë numrin korrekt të pikës fundore të rrjetit publik në të cilin është origjinuar thirrja. Ky numër është një numër i cili është alokuar nga Autoriteti kompetent.

2. Secila palë garanton rrugëzimin transparent të Informacionit të Identitetit të Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur, nga rrjeti i saj dhe dërgimin e Identitetit të Numrit Thirrës në rrjetin e Palës tjetër. Operatori Përfitues detyrohet të garantojë mundësinë e paraqitjes së CLI si dhe mostjetërsimin ose ndryshimin e saj.

3. Çdo ndryshim/modifikim apo fshehje e Identitetit të Numrit Thirrës përbën një shkelje të kushteve të kësaj oferte dhe marrëveshjes me shkrim që do të lidhet me palëve si dhe një shkelje ligjore. Në rastet kur një operator pranon thirrje nga Operatori Përfitues me modifikime ose fshehje të CLI, operatori ka të drejtë ndërprerjen e menjëhershme të ofrimit të shërbimeve.

4. Përshkrimi edhe më i detajuar mbi paraqitjen e identifikimit të linjës thirrëse do të rregullohet me marrëveshje me shkrim.

5. Interkoneksioni do të përdoren nga secila palë në marrëveshjen me shkrim që do të arrihet bazuar në këtë Ofertë Referencë, ekskluzivisht për shërbimet e rena dakord midis palëve. Palët bien dakord dhe marrin obligimin e përgjegjësisë që të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e çdo orvatje për përdorimin e shërbimeve në kundërshtim me qëllimin për të cilin është ofruar si dhe janë përgjegjës për çdo rritje artificiale të trafikut për shkak të ndonjë veprimi abuziv nga palët e treta. Gjithashtu palët bien dakord që të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për shkëmbimin e informacionit në lidhje me bashkëpunimin brenda masave të caktuara për parandalimin e shfaqjes së abuzimeve të tilla në rrjetet përkatëse të palëve dhe eliminimin e tyre.

6. Evidentimi i një ose më shumë situatave të përcaktuara në këtë nen konsiderohet si përdorim abuziv dhe përbën shkelje të kushteve të ofertës referencë dhe të marrëveshjes me shkrim. Në çdo rast, për dëmet financiare që kanë ardhur si pasojë e shkeljeve të përmendura në këtë nen, pala jo në shkelje ka të drejtën e kompensimit dhe faturimit të vlerës financiare, vlerë e cila do të konsiderohet detyrim financiar sipas kushteve dhe termave të kësaj Ofertë Referencë dhe Marrëveshjes me shkrim.

7. Palët nuk do të konsiderohen përgjegjëse në rast të ndonjë kufizimi ose ndërprerje të plotë të interkoneksionit nëse kjo gjykohet e nevojshme nga një organ kompetent si ARKEP, dhe/ose Organ Gjyqësor. Përveç rasteve kur përcaktohet qartësisht nga marrëveshja me shkrim, kapaciteti i interkoneksionit do të përdoret nga Operatori Përfitues vetëm për të realizuar dhe ofruar shërbimet e



përcaktuara me këtë Ofertë dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera të marrëveshjes konform autorizimeve përkatëse dhe akteve të tjera rregulluese nga ARKEP.

8. Palët bien dakord që do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e ndonjë praktike të pandershme, ose zvogëlim apo rritje artificiale të volumit të trafikut si rezultat i veprimeve abuzive të palëve të treta, do të jenë përgjegjës për të njëjtat dhe që do të shkëmbejnë informacionin e lidhur me matjet e trafikut me qëllim parandalimin e shfaqjes së një fenomeni të tillë dhe eliminimin e kësaj sjellje abuzive, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundësitë teknike të rrjeteve/sistemeve të tyre. Në rast se ky aktivitet abuziv origjinohet ose/dhe tranzitohet nga rrjeti/sistemi i njëres palë, do të jetë përgjegjësi e asaj pale dhe do të konsiderohet shkelje e marrëveshjes nga pala tjetër dhe paraqet bazën për shkëputje të menjëhershme të kontratës.

9. IPKO do të kryejë procedurat e nevojshme për implementimin e numeracionit të operatorit përfitues në të gjithë centralet e rrjetit të tij sipas planit të numeracionit kombëtar duke bërë aktivizimin e numeracionit që operatori përfitues paraqet zyrtarisht. Numërformimi dhe formati i numrave të do të rregullohet me marrëveshje me shkrim.

10. Operatori përfitues do të kryejë procedurat e nevojshme për implementimin e numeracionit të IPKO-s, të operatorëve tjetër kombëtar të ndërlidhur me rrjetin e IPKO-s. Numërformimi dhe formati i numrave të do të rregullohet me marrëveshje me shkrim.

11. Palët përcjellin në pikën e interkoneksionit informacionin e plotë të identifikimit të numrit të thirrësit. Në momentin kur njëra palë përcjell thirrjet në rrjetin e Palës tjetër, është e detyruar të transmetojë Identitetin e Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur atë, duke përdorur protokollin e sinjalizimit të paraqitur në këtë Ofertë dhe në pajtim me ato të paraqitura në marrëveshjen me shkrim. Kjo çështje do të rregullohet në detaje me marrëveshje me shkrim.

12. Në rastet kur një operator detekton se operatori përfitues dhe/ose pala e tretë modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të përcjella nga operatori përfitues, operatori do të ndërpresë ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit.

Neni 16

Cilësia e shërbimit

1. IPKO dhe operatori përfitues do të jenë përgjegjës për operimin pikës kufitare të sistemeve të tyre përkatëse të përcaktuar në përputhje me anekset e kësaj oferte dhe marrëveshjes me shkrim. IPKO do të jetë përgjegjës për të siguruar cilësinë e duhur të thirrjeve të bëra/pranuara nga një përdorues fundor i IPKO-s nga pika fundore e rrjetit në të cilën përdoruesi fundor është i lidhur drejt pikës kufitare në interkoneksionin e rrjetit me operatorin përfitues. Operatori përfitues do të jetë përgjegjës për të siguruar cilësinë e duhur të thirrjeve të bëra/pranuara nga përdoruesit tjetër fundor nga pika kufitare në interkoneksionin e rrjetit drejt pikës përfundimtare kufitare të rrjetit të përdoruesit të atillë.

2. IPKO do të regjistrojë edhe përqindjen e thirrjeve të pasuksesshme. Nëse brenda një periudhe të veçantë të faturimit IPKO mat më shumë se 20% të thirrjeve të pasuksesshme, ka të drejtë për të ngarkuar operatorin përfitues për çdo thirrje të pasuksesshme mbi kufirin e 20% brenda periudhës të njëjtë të faturimit. IPKO do të ngarkojë operatorin përfitues për çdo telefonatë të tillë sikur të ishte një telefonatë prej një minutë e kryer mbi interkoneksionin e rrjetit. Operatori përfitues dhe IPKO do të sigurojnë cilësinë e lidhjeve në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi dhe të marrëveshjes që do të arrihet me shkrim.



3. Operatori përfitues do të sigurojë cilësinë e lidhjeve nga përdoruesit fundor në sistemin e operatorit përfitues drejt përdoruesve përfundimtarë në sistemin IPKO në mënyrë të tillë që vonesa nuk mund të kalojë 150 ms (me eliminatorin e jehonës të kyçur). Nëse operatori përfitues nuk ka arritur cilësinë e duhur të lidhjeve dhe nuk ka prezantuar masa për të përmirësuar cilësinë në një periudhë të caktuar të përshtatshme pasi u paralajmërua nga IPKO, ky i fundit mund të kërkojë një dënim kontraktual deri në 20% të shumës së ngarkuar për të gjithë ato thirrje, ku cilësia e pamjaftueshme ka qenë e regjistruar dhe pas informimit të ARKEP mbi ndërprerjen e marrëveshjes dhe shkyçjes së të gjitha shërbimeve.

4. Operatori përfitues është përgjegjës për të siguruar kontrollin mbi gjendjen dhe cilësinë e lidhjes me rrjetin e IPKO-s automatikisht ose me metoda të tjera, të tilla si analiza, teste, matje dhe të ngjashme. Ai është gjithashtu përgjegjës për të hequr gabimet ose parregullsitë në funksion sa më shpejt pasi ato të jenë zbuluar. IPKO do të njoftohet menjëherë për të gjitha gabimet apo parregullsitë e zbuluara. IPKO dhe operatori përfitues do të sigurojnë ekipet e tyre përkatëse të ekspertëve dhe pajisjet teknike për monitorim të pandërprerë 24 orësh dhe funksionimin e papenguar të rrjetit. Të dyja palët do të jenë përgjegjëse për mbrojtjen dhe funksionimin adekuat të rrjeteve të tyre përkatëse deri në pikën kufitare. Nëse IPKO përcakton se mund të ketë pasur disa dëmtime të rrjetit të IPKO-s për shkak të parregullsive në rrjetin e operatorit përfitues, ka të drejtë të përdor cilindo veprim mbrojtës për të mbrojtur rrjetin e saj, e kjo vlen edhe anasjelltas. Në rast të një ndërprerjeje e cila i atribuohet njëres palë, rivendosja është e mundur vetëm pasi që pala që ka shkaktuar dëmin kryen pagesën për dëmin e shkaktuar dhe paraqet dëshmi që tregon qartë se gabimet janë hequr. Rivendosja do të kryhet me shpenzimet e palës që ka shkaktuar dëmin.

5. Nëse vërtetohet se IPKO duhet të kryejë një inspektim të funksionimit të sistemit të tij dhe pajisjet një përdoruesi të fundit me kërkesën e ose në bazë të një gabimi të raportuar nga një përdorues i fundit, dhe nëse kërkesa ose raporti i gabimit është një rezultat i cilësisë së dobët të shërbimeve të operatorit përfitues, IPKO rezervon të drejtën për të ngarkuar operatorin përfitues për ndërhyrjen.

Këto ngarkesa në bazë të kostos do të përfshijnë por nuk do të jenë të kufizuara në:

- Të gjitha shpenzimet lidhur me inspektimin dhe funksionimin e sistemit;
- Të gjitha shpenzimet lidhur me inspektimin e pajisjeve të përdoruesve fundorë;
- Të gjitha shpenzimet lidhur me intervenimin për të zgjidhur gabimin e raportuar;
- Të gjitha shpenzimet lidhur me përmirësimin dhe/ose zëvendësimin e pajisjeve.

IPKO dhe operatori përfitues sigurojnë komunikimin me përdoruesit përfundimtarë ose parapaguesit e tyre përkatës dhe përmirësojnë gabimet në përputhje me detyrimin e tyre të përcaktuar në këtë ofertë referente dhe marrëveshje.

Neni 17

Përmirësimi i gabimeve

1. IPKO dhe operatori përfitues duhet të njoftojnë palën tjetër për të gjitha gabimet e zbuluara, të cilat mund të ndikojnë në funksionimin e interkoneksionin e rrjetit në çdo mënyrë sa më shpejt të jetë e mundur. Përndryshe, pala e cila ka zbuluar gabimin dhe nuk e ka informuar palën tjetër do të jetë përgjegjëse për të gjitha shpenzimet dhe dëmet të cilat krijohen në rrjetin e palës tjetër.

2. IPKO dhe operatori përfitues do të marrin përsipër të kryejnë mirëmbajtjen e rregullt në kohën e natës në mes të 00:00 dhe 06:00 dhe për të njoftuar të gjithë mirëmbajtjen e rregullt e cila mund të rezultojë



në një ndërprerje apo pengesë në trafikun e palës tjetër të paktën shtatë ditë

paraprakisht. IPKO dhe operatori përfitues angazhohen të akordojnë korrigjimin prioritar të gjitha gabimeve në sistem dhe interkoneksionin e rrjetit të cilat janë objekt i kësaj oferte referente, si dhe të bashkërendisin prioritetet në zgjidhjen e gabimeve ose për të filluar përmirësimin e gabimeve sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda katër orëve pasi që gabimi është zbuluar apo raportuar.

3. Pala e cila zbulon një gabim në funksionimin e rrjetit është përgjegjëse për dhe duhet zgjidhur gabimin sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse afati nga ky paragraf tejkalohet, një afat shtesë mund të aranzhohet nëse mosfunksionimi ose gabimi është më serioz. Nëse pala nuk e ka zgjidhur gabimin para skadimit të këtij afati, ndërlidhja e rrjetit do të pezullohet përkohësisht deri sa gabimi ose mosfunksionimi të jenë zgjidhur. Operatori përfitues duhet të zgjidhë gabimet funksionale, mosfunksionimin ose parregullsitë. Gjatë caktimit të afateve për riparimin e gabimeve funksionale, mosfunksionimit dhe parregullsive, operatori përfitues duhet të jetë në pajtueshmëri me rekomandimet e ITU-së dhe të ETSI të përshkruara në nenin 1 paragrafi 3.3 të kësaj Oferte dhe në Shtojcën 1 të kësaj oferte.

4. Pikat e kontaktit për raportimin e gabimeve do të specifikohen në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit. Palët përkatëse nuk do të jenë përgjegjëse për gabime funksionale të interkoneksionit të rrjetit të cilat janë rezultat i mosfunksionimit të rrjetit, mirëmbajtjes ose përmirësimit apo për shkak arsyeve tjera (të ngjashme) përveç nëse rezulton se një palë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë i ka shkaktuar palës tjetër dëme. Pala e cila ka shkaktuar gabimin duhet të paguajë palës tjetër shpenzimet e testimit që ajo ka pasur.

Neni 18

Përshkrimi i rrjetit dhe ndërfaqes (interface) – standardet dhe kërkesat teknike

Përshkrimi i rrjetit dhe ndërfaqes është paraqitur në shtojcat e kësaj Referencë e që mund të plotësohet edhe përmes marrëveshjes me shkrim.

Neni 19

Normat dhe bashkëpunimi operativ

1. IPKO dhe operatori përfitues do të arrijnë një marrëveshje mbi atë se si të veprojnë dhe të përmbushin marrëveshjen dhe do të përqipen për të zgjidhur të gjitha problemet që mund të lindin gjatë zbatimit të dispozitave të marrëveshjes. IPKO dhe operatori përfitues do të veprojnë brenda normave të miratuara dhe procedurave operative dhe nuk duhet të bëjnë ose të lejojnë që asgjë të kryhet apo të suspendohet në lidhje me funksionimin e sistemit të palës tjetër që do të shkaktonte dëme në atë sistem ose do të shkaktojë nevojën për një ndryshim në funksionimin e këtij sistemi, përveç nëse nuk është rënë dakord ndryshe në një marrëveshje me shkrim.

2. Në kohën e testimit të interkoneksionit të rrjetit, IPKO dhe operatori përfitues do të informojnë njëri tjetrin për karakteristikat e sistemeve të tyre përkatëse të nevojshme për përmbushjen e marrëveshjes për interkoneksionin e rrjetit dhe të cilat nuk janë sekrete afariste, dhe të bashkëpunojnë për qëllime të testimit të kërkuar të sistemit. IPKO dhe operatori përfitues duhet në kohën e duhur të informojë palën tjetër në lidhje me ndonjë iniciativë për ndryshime në sistemin e vet ose në ndonjë pajisje të përfshirë



në sistemin ose në ndonjë komandë apo të dhëna, në qoftë se këto ndryshime pasi të jenë kryer do të kenë ndikime materiale dhe/ose teknike – biznesore në palën tjetër.

3. Nëse rregulloret për komunikimet elektronike kërkojnë që të dyja palët të kryejnë ndryshime në sistemet e tyre respektive, ato duhet të kryejnë të gjitha ndryshimet që rezultojnë të kërkuara sa më shpejt të jetë e mundur. Secila palë duhet të mbuloj shpenzimet e veta që dalin nga këto ndryshime. Nëse njëra nga palët dëshiron për të kryer ndonjë ndryshim në sistemin e saj dhe ky ndryshim kërkon ndryshime në sistemin e palës tjetër, ajo duhet të njoftojë palën tjetër dhe të propozojë një marrëveshje për kryerjen e këtyre ndryshimeve dhe për të gjitha kostot që mund të lindin nga një ndryshim i tillë. Palët do të nënshkruajnë një marrëveshje me shkrim për pagesën e shpenzimeve të bëra.

4. Në qoftë se ndryshimi në sistem është praktikisht i pamundur për tu kryer, ose në qoftë se ka ndonjë paqartësi ose probleme të tjera të cilat mund të dëmtojnë funksionimin e sistemit të IPKO-s dhe / ose sistemit të operatorit përfitues, njëra palë do të informojë menjëherë palën tjetër. Nëse operacioni apo pajtueshmëria e sistemit të IPKO-s dhe sistemit të operatorit përfitues është dëmtuar, palët do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje për kryerjen e ndryshimeve të kërkuara dhe mbi shpenzimet e këtyre ndryshimeve, ndërsa IPKO nuk është përgjegjës për mbulimin e shpenzimeve të operatorit përfitues për rregullimin e sistemi i tij ndaj atij të IPKO-s.

Neni 20

Procedurat e porositjes dhe njoftimit

1. Orari i punës i zyrës së IPKO-s është nga e hëna në të premte prej 08:30 deri 16:30, me përjashtim të festave kombëtare. Çdo kërkesë nga operatori përfitues, e cila nuk është dërguar gjatë orarit të punës së IPKO-s, do të procedohet në ditën pasardhëse të punës në orën 08:30.

2. Kërkesat për sigurimin e linjave të interkoneksionit duhet të dorëzohen në IPKO nga operatori përfitues, me shkrim. Një përgjigje pozitive për kërkesën e operatorit përfitues është një përgjigje të cilën IPKO do të dërgojë operatorit përfitues me shkrim brenda 30 ditëve pune. Nëse linjat e nevojshme të interkoneksionit janë në dispozicion për realizimin e kapaciteteve në interkoneksionin e rrjetit, IPKO do të sigurojë realizimin e kërkesave të operatorit përfitues brenda një minimumi prej 90 ditë pune nga konfirmimi i ofertës nga operatori përfitues. Nëse linjat e nevojshme të interkoneksionit nuk janë në dispozicion për realizimin e kërkesës, kur teknikisht është e realizueshme, IPKO do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të realizuar kërkesat e operatorit përfitues brenda një afati kohor të arsyeshëm.

3. IPKO do të prezantoj ndryshime të parametrave në kapacitetet e hyrjes dhe të linjave të tjera shtesë të sinjalit mbi lidhjet ekzistuese brenda 60 ditëve pas konfirmimit të ofertës nga operatori përfitues.

Në përputhje me aftësitë teknike, IPKO do të përmbush të gjitha kërkesat e arsyeshme dhe të mundshme të operatorit përfitues. IPKO do të përgjigjet në kërkesat sipas radhës në të cilën janë pranuar, ose kur disa kërkesa janë të pranuar në të njëjtën kohë, do të zgjedhin kërkesat më të favorshme, ku kriteret janë:

- përdorimi më i mirë i kapaciteteve të lira të linjave të komunikimit elektronik;
- kërkesa është pjesë e një procedure komplekse të veprimit në përputhje me kërkesat e qiramarrësit;
- kërkesa përfaqëson investimin më të vogël për IPKO-n;
- kërkesa i referohet dhënies me qira të kapaciteteve të cilat janë të destinuar për aplikimet, interesante për IPKO-n.



Neni 21

Sanksionet për shkeljet e kushteve dhe përjashtimi e kufizimi i përgjegjësisë

1. Në rast të shkeljes së kushteve të cilat lindin nga sfera e palës së dytë, çdo palë mund të zbatojë sanksionet e mëposhtme:

- Të kërkojë nga pala tjetër për t'i dhënë fund shkeljeve brenda 24 orëve;
- Menjëherë të mbyll pajisjet e operatorit përfitues që janë duke shkaktuar ndërprerje apo dëme;
- Përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht të ndalojë interkoneksionin e palës tjetër në rrjet, objekte apo pajisje;
- Të kërkojë kompensim;
- Të ndërpresë marrëveshjen nëse pala tjetër ka dështuar t'i japë fund shkeljeve brenda 24 orëve ose në qoftë se pala është në shkelje të kushteve;
- Menjëherë të mbyllë pajisjet e operatorit përfitues dhe tërësisht të ndalojë interkoneksionin e palës tjetër në të gjitha rastet e mashtrimit;
- Përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht të mbyllë pajisjet e operatorit përfitues dhe të ndalojë interkoneksionin palës tjetër në të gjitha rastet e dyshimit të mashtrimit potencial.

2. Palët mund të ushtrojnë sanksionet e numëruara në mënyrë proporcionale me shkallën e shkeljes. Palët nuk janë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar duke zbatuar sanksionet e mësipërme. Një palë nuk është përgjegjëse për dëmet ndaj palës tjetër, përveç nëse është vërtetuar se ajo ka vepruar me qëllim të shkakimit të dëmeve ose dëmet i ka shkaktuar nga pakujdesia e rëndë, në rastet e mëposhtme:

- Dështimi i rrjetit ose pajisjes për shkak të defektit, mirëmbajtjes apo arsyeve të tjera;
- Çdo heqje e përkohshme ose e përhershme ose kufizimi për interkoneksionin e rrjetit për të siguruar funksionimin e sigurt të rrjetit, për të ruajtur integritetin e rrjetit apo për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve dhe rastet e mashtrimeve të mundshme dhe të mashtrimit;
- Kufizimi i përkohshëm i interkoneksionit të operatorit përfitues ose ndonjë palë tjetër për shkak të riparimeve, mirëmbajtjes ose përmirësimit të rrjetit ose të pajisjeve të palës, apo për shkak të arsyeve të tjera të rëndësishme;
- Veprimet e bazuara në rregulloret ose vendimin e organit shtetëror ose titullarit të autorizimeve publike;
- Dëmet e shkaktuara në përdoruesit fundor;
- Dëmet e shkaktuara nga përmbajtja e bartur mbi rrjet;
- Dëmet që janë të shkaktuara nga forca madhore.

Në çdo rast, dëmet që duhet të paguhen nga cilado palë janë të kufizuara në EUR 10,000 për çdo shkelje. Në çdo rast, kur operatori përfitues dështon pas aprovimit të marrëveshjes, operatori përfitues është i obliguar që brenda 10 ditëve t'ia paguaj IPKO-s shumën totale të kontraktuar.

Neni 22

Rregullat e procedurës së kontratës

1. Operatori përfitues që dëshiron të hyjë në një marrëveshje të interkoneksionit të rrjetit – terminimit të thirrjeve me IPKO-n për telefoninë mobile, duhet të ofrojë IPKO-s letrën e qëllimit (kërkesë



standarde), ku duhet të shprehen qartë synimet e palës për të krijuar interkoneksion të rrjetit – terminim të thirrjeve me sistemin e IPKO-s për telefoninë mobile.

2. Duke ofruar letrën e qëllimit (kërkesë standarde), operatori përfitues pajtohet me kushtet tipike të ofertës referente dhe se ajo nuk do të përpiqet për të arritur kushte të ndryshme të interkoneksionit të rrjetit – terminimit të thirrjeve duke negociuar para nënshkrimit të marrëveshjes. Palët gjithashtu pajtohen se çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ofertë do të negociohen dhe përmyllen përmes marrëveshjes me shkrim e cila do të jetë në pajtim me këtë ofertë.

3. Operatori përfitues duhet të bashkëngjisë të dhënat e mëposhtme në kërkesën standarde:

- Certifikata mbi regjistrimit e biznesit;
- Certifikata e TVSH-së;
- Certifikata e Numrit Fiskal;
- Licenca/Autorizimi për shërbimet e lëshuar nga ARKEP;
- Dokumenti mbi përshkrimin dhe specifikimin e shërbimeve të kërkuara për interkoneksion me IPKO Telecommunications LLC;
- Dokumentin mbi kapacitetin fillestar të kërkuar dhe parashikimet për 12 mujorin të trafikut që do të zbatohen me interkoneksion;
- Dokumentin mbi specifikimin e lokacionit të propozuar të pikave të qasjes të IPKO Telecommunications LLC në të cilat kërkohet ndërlidhja për interkoneksion;
- Lista e pajisjeve të përdorura për interkoneksion dhe specifikimi i tyre;
- Dëshmi të pajisjeve të komunikimit mbi pajtueshmërinë e pajisjeve me standardet e duhura teknike të përcaktuara me ligj, ligjet e përgjithshme të Telekomunikacionit dhe standardet e ETSI, ITU-T si dhe normat dhe standardet që zbatohen në Bashkimin Evropian, për pajisjet dhe mjetet në rrjetin e Operatorit të cilat janë të nevojshme për t'u lidhur në rrjetin të cilat janë të nevojshme për t'u lidhur në rrjetin e IPKO Telecommunications LLC;
- Një deklaratë të vërtetuar se procedurat e falimentimit, likuidimit ose zgjidhjes të detyruar nuk janë iniciuar kundër parashtruesit të kërkesës;
- Certifikata e përshtatshmërisë për të kryer shërbimet që kanë për qëllim të kryhen si pjesë e interkoneksionit të rrjetit me IPKO-n;
- Një përshkrim të sistemit të operatorit përfitues me informata themelore rreth rrjetit të komunikimit apo pajisjeve të komunikimeve elektronike që do të përdoren, duke përfshirë një propozim për sinkronizimin me sistemin e operatorit përfitues;
- Propozimi i një interkoneksioni të rrjetit duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:
 - o Lista e shërbimeve që dëshirojnë të kryejnë;
 - o Nevojat e kapaciteteve fillestare dhe plani për 12 muajt në vijim duke përfshirë shërbimet e ndara në tipe të shërbimeve;
 - o Informacionin bazë në lidhje me vendndodhjen e tyre;
 - o Skemën e lidhjes së sistemit të operatorit përfitues (pika e lidhjes);
 - o Llogaritjet o trafikut për ndërlidhjen e rrjetit;
 - o Përshkrimet e ndërfaqeve;
 - o Numrin e porteve të nevojshme;
 - o Planin e zbatimit;
 - o Planin e tokëzimit;
- Kopje të vendimeve të ARKEP-it mbi alokimin e numrave lidhur me shërbimet e Propozuar
- Detajet e personave përgjegjës për marrëveshje, detajet e marrëveshjeve të personave përgjegjës për çështje teknike;
- Planin e kërkesës për linjat e sinjalit dhe linjat e interkoneksionit, përfshirë vëllimin e planifikuar



të trafikut, të ndarë sipas llojeve të trafikut, për vitin e parë të zbatimit të interkoneksionit të rrjetit (vëllimi i planifikuar i trafikut duhet të ndahet sipas kohës së ngarkesës së ulët dhe të lartë të punës dhe sipas pikave të ndryshme të ndërprerjes të interkoneksionit të rrjetit);

- Standardet teknike dhe të cilësisë, që do të përcillen gjatë ofrimit të shërbimeve të telekomunikacioni
- Përshkrimi i shërbimeve të kërkuara nga IPKO nga operatori përfitues;
- Një propozim të sigurimit të pagesës të obligimeve kontraktuese të porositura dhe pagesa e tyre për së paku një vit të lidhjes së sugjeruar.

4. IPKO do të shqyrtojë dokumentacioni brenda 30 ditëve, dhe nëse është e nevojshme, do të kërkojë sqarime shtesë. Nëse IPKO nuk kërkon shpjegime shtesë, një marrëveshje për mbrojtjen e sekretit afarist do ti dërgohet operatorit përfitues për nënshkrim. Operatori përfitues duhet të kthejë marrëveshjen e nënshkruar brenda pesë (5) ditëve nga marrja e saj, ose do të konsiderohet se ka hequr dorë nga qëllimi. Negociatat ndërmjet IPKO dhe operatorit përfitues do të fillojnë në ditën kur IPKO merr letrën për qëllimin së bashku me tërë shtojcat e kërkuara.

5. Detaje të tjera shtesë në lidhje me rivendosje të IPKO-s dhe operatorit përfitues duhet të specifikohen në marrëveshje dhe shtojca të marrëveshjes varësisht nga zgjidhjet teknike specifike. Para përfundimit të interkoneksionit komercial IPKO dhe operatori përfitues duhet të kontrollojnë operimin teknik dhe rutimin e thirrjeve. Ata duhet që të kryejnë të gjitha testimet e nevojshme në pajtim me rekomandimet e ITU ose ETSI. Testimi do të kryhet nën protokollin e prezantuar nga IPKO.

6. Pas verifikimit të performancës teknike the rutimit të thirrjeve ata duhet të verifikojnë operimin e llogaritjes së trafikut të interkoneksionit. Operatori përfitues do të kryej thirrje tesimi në çdo skript thirrës të kontraktuar dhe analizë të detajuar krahasuese të rezultateve të matjes. Për shkak të tipareve teknike të sistemit mund të kërkohet që IPKO të drejtoj trafikun dhe identifikoj, për të cilën palët do të pajtohen me marrëveshje me shkrim.

7. Për të siguruar transparencë, operatori përfitues do të kryej të gjitha shërbimet e interkoneksionit me IPKO-n pa asnjë filter dhe manipulim dhe siguroj CLI për të gjitha thirrjet. Përveç detajeve të kërkesën standarde operatori përfitues pajtohet që të parashtrij këto shtojca:

- Dizajni inxhinierik i interkoneksionit të propozuar me listën e shërbimeve të kërkuara, dhe metoda e dhënies së shërbimit;
- Paraqitja arkitektonike e rrjetit të investitorit: informatat bazike për rrjetin e tij dhe pajisjet që do të përdoren për interkoneksion;
- Përshkrim teknik i propozimit dhe teknologjia e përdorur për interkoneksion, që përmban përshkrim të detajuar të pikës ndërlidhëse dhe paraqes përshkrimin e rrugës së transmisionit në mes të pikës terminuese dhe të asaj të IPKO-s;
- Përshkrim teknik dhe i standardeve të kualitetit që do të përdoren për shërbimet e interkoneksionit;
- Propozim i kapacitetit fillestar të interkoneksionit të shoqëruar me kalkulime duke përfshirë numrin e shërbimeve për vitin e parë;
- Deklarata e pranimit të metodës së sinkronizimit me sistemin e IPKO-s në;
- Deklarata për dhënien e IT mbështetjes për matje dhe faturim të trafikut;
- Me kërkesë të IPKO-s operatori përfitues duhet të parashtrij certifikate për testimin e pajisjeve të saja për të përmbushur kërkesën e saktësisë dhe saktësisë së matjeve;



- Deklaratë që operatori përfitues garanton nëse konektorët e tij japin informata për identitetin e thirrësit (CLI);
- Deklaratë që operatori përfitues nuk do të kryej dhe nuk do të marr pjesë në asnjë mënyrë në kryerjen e filtrimit ose të manipulimit që do të mund të pamundësonte gjurmimin dhe kontrollin e trafikut dhe se do të jap transparence (CLI) në të gjitha thirrjet.

Neni 23

Sigurimi i përgjegjësive

1. Para se të nënshkruhet marrëveshja, operatori përfitues duhet të sigurojë pagesat e menjëhershme nga shtojcat e kësaj oferte referencë dhe një apo më shumë forma të përshtatshme të sigurimit për të paktën shumën totale të detyrimeve të tij të vlerësuara ndaj IPKO-s që janë të pagueshme menjëherë pas aktivizimit të interkoneksionit të rrjetit që do të rregullohen në marrëveshjen me shkrim. Shuma e saktë caktohet nga IPKO bazuar në Shtojcat e kësaj oferte referente dhe planet e operatorit përfitues, të përcaktuara në Shtojcën e letrës së qëllimit. Nëse çmimet ose vëllimet e shërbimeve rriten në periudhën e mëvonshme, IPKO ka të drejtë të kërkojë një shumë më të lartë të sigurimit nga operatori përfitues, e cila duhet të jepet brenda 15 ditëve nga kërkesa. Operatori përfitues do të ofrojë IPKO-s një provë të përshtatshme të sigurimit. Format vijuese të sigurimit janë të pranueshme:

- një garanci bankare për t'u paguar në kërkesën e parë në shumën e përshkruar më poshtë, në bazë të kostos dhe planit të operatorit përfitues;
- një pagesë paradhënie në shumën e përshkruar më poshtë, në bazë të kostos dhe planit të operatorit përfitues. Paga e paradhënies së sigurimit kërkon një marrëveshje të veçantë midis operatorit përfitues dhe IPKO-s.

2. Forma e parë e sigurimeve nga lista e mësipërme duhet të ketë një vlefshmëri të paktën një (1) vit. IPKO mund të kërkojë një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së sigurimit. Nëse në periudhat e mëvonshme ndodhin pagesat e vonuara të përshkruara më poshtë ose ankesa të cilat qartazi janë të pabazuara, IPKO mund të kërkojë një sigurim të ri.

3. IPKO gjithashtu mund të kërkojë një sigurim të ri në përputhje me paragrafin e parë në qoftë se pagesat me vonesë ose ankesat qartazi të pabazuara në lidhje me detyrimet e operatorit përfitues ndodhin pasi pagesa e paradhënies, e cila ishte pjesë e sigurimit të pagesës së paradhënies, është shterur.

4. IPKO mund të shndërrojë sigurimin në para të gatshme në rastet e mëposhtme:

- brenda 24 orëve nëse operatori përfitues nuk paguan detyrimet e tij të papaguara për shërbimet e interkoneksionit të rrjetit edhe pse ka pranuar një përkujtim mbi pagesën;
- nëse operatori përfitues nuk paguan gjokat e tij kontraktuese nga oferta referente ose marrëveshja brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës;
- nëse operatori përfitues nuk paguan dëmet e shkaktuara drejt IPKO-s me shkeljen e tij të detyrimeve kontraktuese ose standardeve teknike brenda 24 orëve nga data e vlerësimit të dëmeve.

5. Shuma e garancisë bankare dhe/ose paradhënies në valutën euro, do të llogaritet, vendoset në shumë të saktë me arsyetimin dhe kërkesën nga IPKO në përputhje me vlerësimin e IPKO-s

në marrëveshjen me shkrim. Ky vlerësim do të marrë në konsideratë planin e zbatimit që duhet të sigurohet nga operatori përfitues, siç përshkruhet në këtë oferte referencë.



6. Garancia bankare që do të parashtrohet nga Operatori Përfitues në favor të IPKO-s do të jetë me vlefshmëri prej së paku 12 (dymbëdhjetë) muajve duke filluar nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes me shkrim dhe do të rinovohet (dorëzim i garancisë bankare të ri) një muaj para skadimit të afatit të përcaktuar me marrëveshje me shkrim. Operatori Përfitues detyrohet që brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes të parashtrij pranë IPKO-s garancinë bankare të depozituar në një bankë komerciale në Republikën e Kosovës.

6.1 Shuma e garancisë bankare do të përlogaritet në bazë të parashikimeve të trafikut jo më pak se 12 muaj të trafikut të paraqitur të Operatorit Përfitues dhe rrezikut të IPKO-s. Vlera e garancisë bankare do të rishikohet me rastin e lidhjes së marrëveshjes së re të interkoneksionit ose në raste të ndryshimeve të ndjeshme të volumit të trafikut. Ndryshimi i ndjeshëm i trafikut do të konsiderohet ndryshimi me 30% i detyrimeve neto të tre muajve të fundit, krahasuar me detyrimin neto mbi të cilin është bërë llogaritja e fundit e garancisë.

Neni 24

Periudha e vlefshmërisë dhe tërheqja nga marrëveshja

1. Marrëveshja do të nënshkruhet për periudhën e rënë dakord së bashku, por jo më pak se 1 vit. Pas kësaj periudhe, nëse njëra nga palët dëshiron të tërhiqet nga marrëveshja duke dërguar palës tjetër një njoftim me shkrim me këshillë të pranimit së paku tre (3) muaj para datës së skadimit të periudhave të vlefshmërisë individuale, marrëveshja do të rinovohet automatikisht për periudhën shtesë një vjeçare.

2. IPKO dhe operatori përfitues po ashtu mund të ndërpresin marrëveshjen:

- pas një paralajmërimi paraprak prej tre (3) muaj, në rast se një palë e humbet pozicionin e saj juridik si një operator me fuqi të ndjeshme në treg, ose në qoftë se detyrimi i tij për të nënshkruar një marrëveshje të interkoneksionit të rrjetit me operatorin përfitues pushon së ekzistuari;
- pa njoftim paraprak, nëse IPKO ose operatori përfitues janë të përfshirë në një procedurë të falimentimit se shlyerjen e detyrueshme;
- pa njoftim paraprak në të gjitha rastet e mashtrimit ose tentimit të mashtrimit, keqpërdorimit, mos pagesës ose të refuzimit për të paguar faturat brenda 15 ditëve, duke mos qenë në gjendje të paraqesë dhe të përtërijë garancinë bankare dhe/ose paradhënien, dhe çdo shkelje tjetër e rëndë e kësaj oferte referente.

3. Marrëveshja ndërpritet sipas ligjit, nëse ndonjë prej operatorëve përfitues humbasin të drejtën e tyre për të ofruar shërbime të cilat janë me rëndësi jetike për zbatimin e marrëveshjes. Nëse është e nevojshme, Marrëveshja me shkrim për interkoneksionin e rrjetit gjithashtu mund të ndërpritet në mënyrë për të garantuar sigurinë e operacioneve të rrjetit, për të ruajtur integritetin e rrjetit, mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me rregullat e sigurisë së rrjetit, apo për të siguruar një përdorim racional të spektrit të frekuencave.

Neni 25

Fillimi i vlefshmërisë dhe modifikimet e ofertës referencë



1. Oferta referencë hyn në fuqi në ditën pas botimit në faqen e internetit të IPKO-s. IPKO do të ndryshojë dhe përditësojë rrjetin e saj bazuar në operacionet e saj të biznesit dhe në përputhje me standardet dhe rekomandimet e pranuar ndërkombëtarisht. Për këto dhe arsye të tjera të rëndësishme, IPKO mund të ndryshojë kushtet e kësaj oferte referente në çdo kohë.

2. IPKO do t'i japë operatorit përfitues një njoftim 90 ditësh për planet për ndryshime të mëdha infrastrukturore që mund të ndikojnë në interkoneksionin e rrjetit për operatorin përfitues. Kjo ofertë referencë mund të ndryshojë në bazë të vendimeve të ARKEP, të aktgjykimeve të formës së prerë nga gjykata, apo kërkesave të rregulloreve në fuqi. Çdo modifikim i ofertës referente do të publikohet në faqet e internetit të IPKO-s.

Neni 26

Mbrojtja e informacionit konfidencial

1. Operatori përfitues është i detyruar që të përdor informacionin e marrë në lidhje me ofertën referencë vetëm për qëllimet për të cilat informacioni është marrë. Të gjitha informatat në lidhje me rrjetin e IPKO-s, shërbimet, pajisjet, apo strategjitë e biznesit, ose informacionet tjera nga gama e operacioneve të IPKO-s që i bëhen të njohura operatorit përfitues gjatë negociatave, kërkesat, nënshkrimi ose përmbushja e marrëveshjes me shkrim, ose me çdo mjet tjetër, konsiderohen si sekret afarist i IPKO-s, përveç nëse nuk dakordohet ndryshe nga palët në bazë të një deklarate me shkrim të zbatueshme për raste të veçanta.

2. Për çdo dyshim të bazuar të shkeljes së sekretit afarist dhe konfidencialitetit të përmendur më lartë, të kryera nga operatori përfitues, të punësuarit e tij, nënkontraktuesit, apo persona të tjerë të ndërlidhur, IPKO ka të drejtën e pezullimit të menjëhershëm të marrëveshjes dhe shërbimeve, duke njoftuar menjëherë ARKEP-in dhe Policinë e Kosovës me qëllim të zgjidhjes të çështjes sipas ligjit në fuqi.

3. Operatori përfitues si dhe punonjësit dhe nënkontraktuesit e tij janë të detyruar të ruajnë sekretet afariste të IPKO-s në përputhje me rregulloret mbi përgjegjësinë penale dhe civile; operatori përfitues ka për të siguruar se punonjësit dhe nënkontraktuesit e tij janë të informuar për këtë detyrë. Për çdo shkelje të provuar të sekretit afarist të përmendur më lartë, të kryera nga operatori përfitues, të punësuarit e tij, nënkontraktuesit, apo persona të tjerë të ndërlidhur, operatori përfitues do të paguajë IPKO-s një dënim kontraktues në shumën prej 10,000 EUR për çdo shkelje dhe IPKO do të ketë të drejtën për të ndërprerë marrëveshjen/shërbimet, në varësi nga natyra dhe shkalla e zbulimit të informacionit.

4. Të dyja palët dhe të gjithë personat e punësuar që janë të involvuar direkt ose indirekt në këtë çështje janë të detyruara të ruajnë sekretin dhe konfidencialitetin e komunikimeve elektronike, si dhe të dhënat personale të përdoruesve dhe parapaguesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Personat e listuar më sipër duhet të ruajë sekretin afarist gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes dhe ky obligim mbetet edhe pasi të jenë përfunduar të gjitha aktivitetet të cilat ata kanë qenë të obliguar t'i ruajnë.

Neni

Procedurat

27

1. Operatori përfitues do të parashtrij kërkesë standarde pranë IPKO-s me të gjitha dokumentet e nevojshme të përshkruar në këtë dokument. Në rast se IPKO konstaton se operatori përfitues i plotëson të gjitha kushte ligjore dhe teknike brenda afatit të përcaktuar nga IPKO, i fundit do të dërgon marrëveshjet e nevojshme për mos shpalosjen e sekreteve dhe të dhënave. Nënshkrimi i marrëveshjes

22



për mbrojtjen e sekretit afarist është parakusht për përpilimin e draft marrëveshjes ose të të gjitha dokumenteve dhe çështjeve të tjera pa dallim. Nëse operatori përfitues nuk përgjigjet në këtë kërkesë duke kthyer këtë dokument të nënshkruar brenda afatit prej 5 ditëve IPKO do të konsideron që operatori përfitues ka tërhequr kërkesën dhe do të refuzoj aplikacionin.

2. Brenda afatit prej 15 ditëve IPKO do të shqyrton kërkesat dhe në rast të nevojës së dokumentacionit shtesë ose të sqarimeve do të kërkon parashtrimin e dokumentacionit shtesë. Në rast se operatori përfitues nuk përmbush kërkesën për dokumentacion shtesë brenda afatit prej 5 ditëve IPKO do të konsideron që operatori përfitues ka tërhequr kërkesën dhe do të refuzoj aplikacionin.

3. Afati lidhur me kthimin e draft kontratës do të përcaktohet me draft kontratë/ marrëveshje dhe nëse i njëjti nuk respektohet IPKO do të konsideron që operatori ka tërhequr kërkesën dhe do të refuzoj aplikacionin.

4. Aplikacioni do të konsiderohet i plotë vetëm nëse:

- o Operatori përfitues parashtron të gjitha dokumentet e kërkuara nga IPKO, brenda afateve të përcaktuara;
- o Nënshkruan marrëveshjet për mbrojtje të sekreteve afariste dhe të gjitha dokumente të tjera të kërkuara nga IPKO;
- o Aprovimi i dizajnit inxhinierik të interkoneksionit;
- o Konfirmon kapacitetin:
 - Parashtron kontratë të shkruar për implementimin e interkoneksionit në pajtim me këtë dokument dhe paguan koston në pajtim me deklaratën
 - Nënshkruan marrëveshjen për interkoneksion dhe parashtron garancionin bankar dhe pagesën paraprake për të siguruar pagesat e ardhme.

5. Duke u bazuar vetëm në një aplikim total dhe komplet, IPKO do të filloj procesin e interkoneksionit vetëm pasi që të jenë përmbushur të gjitha kërkesat e parashtruara në këtë dokument dhe në marrëveshje. Integrimi komercial do të kryhet vetëm pas përmbushjes së këtyre kërkesave:

- Kontrata për interkoneksion e nënshkruar në mes të IPKO-s dhe operatorit përfitues;
- Operatori përfitues i ka përmbushur të gjitha obligimet kontraktuale;
- Lidhje fizike në mes rrjeteve është vendosur dhe testuar me sukses;
- IPKO dhe operatori përfitues bazohen në test thirrje në pajtim me skenarët e pajtuara sipas marrëveshjes dhe kontrollojnë sistemin e kalkulimit të tarifave dhe konfirmojnë korrektësinë e operimit të tyre.

Neni 28

Zgjidhja e kontesteve

1. Mosmarrëveshjet eventuale në lidhje me këtë ofertë referuese do të jetë objekt shqyrtimi nga të dy palët, nëse nuk mund të gjendet ndonjë zgjidhje e pranueshme për palët atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Tribunali i Arbitrazhit i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Tribunali

i Arbitrazhit do të zgjidh kontestin në pajtim me rregullat e saja procedurale dhe Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

2. Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga një trup arbitrash prej tri arbitrave. Secila palë do të emëroj një arbitër dhe arbitri i tretë (drejtuesi) do të emërohet nga dy arbitrat e emëruar. Gjuha që do të përdoret gjatë procedurës së arbitrazhit do të jetë gjuha shqipe. Të gjitha procedurat do të jenë konfidenciale, duke



përfshirë dokumentacionin e prezantuar nga palët gjatë procedurës. Vendimi i Tribunalit të Arbitrazhit do të jetë final.

Neni 29

Trashëgimia juridike

Trashëgimia juridike rregullohet me dispozitat e ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Shtojca 1: Pika e lidhjeve

1. Pika e lidhjeve në ndërprerësin e butë të klasës 4 të IPKO-s për terminimin e thirrjeve në rrjetin e IPKO-s.

Operatori përfitues mund të lidhet në IPKO MGW dhe rregullat e mëposhtme duhet të respektohen. Qasja e operatorit përfitues në të gjithë përdoruesit përfundimtarë të IPKO-s është në bazë të numërimit 038. Rutimi i trafikut dhe numri i linjave të rrjetit individual të interkoneksionit është përcaktuar në bazë të përdorimit optimal të sistemit të IPKO-s nga IPKO ose kërkesa e operatorit përfitues. Sipas kësaj pikë të lidhjeve operatori përfitues i cili terminon thirrjen kombëtare drejt përdoruesit përfundimtar i qaset sistemit të IPKO-s dhe çdo operator përfitues mund të lidhet në PoC (pika e lidhjes).

- Për operatorin përfitues për tu lidhur në sistemin e IPKO-s:
Lloji i sinjalizimit të PoC duhet të jetë SS7. Të dhënat themelore dhe funksionaliteti janë përshkruar më poshtë.

2. Të dhënat themelore:

- Tipi i IPKO Exchange për SS7: Ericsson(SW R6760 – 16A)
- MTP versioni: MTP i bardhë sipas ITU-T Q. 701
- ISUP versioni: ISUP v2 Q.761 - Q. 764 dhe ETSI ISUP versioni 2 ETS 300 356-1...12,-14.....19 në përputhje
- Lloji i sinjalit në pikën e lidhjes: SP, STP në përputhje
- Ndërfaqja në nivelin e 1rë të modelit OSI: Ndërfaqja A në përputhje me ITU-T G.703 rekomandohet në përputhje
- Elektrikisht i përputhshëm me 2048 kbit/s ndërfaqe.
- Sinkronizimi i inputit (TUB dhe TUB2-cards): Elektrikisht në përputhje.
- Ndërfaqet në nivelin e 2-të të modelit OSI: struktura e kornizimit (framing structure) në përputhje me ITU-T G.704 rekomandohet në përputhje
- Në përputhje për strukturën themelore të kornizës prej 2048 kbit/s që bartë nx64 kbit/s kanale pa CAS.
- Lloji i IPKO Exchange për SIP: NetCentrex
- Protokollin e sinjalit: SIPv2 sipas standardeve RFC3261 IETF. Nuk përdoret për momentin
- Protokollin e transportit: RTP dhe RTCP sipas standardeve RFC3550 IETF pjesërisht në përputhje
- RTCP nuk përkrahet plotësisht.
- Mbështetja për Codecs: REC G.711A-Law, REC G.711u-Law dhe REC G.729 sipas standardeve ITU-T në përputhje
- Protokollin e IP: IPv4 sipas standardeve RFC1918 IETF në përputhje
- Ndërfaqja në modelin OSI: Ndërfaqja në përputhje me standardet IEEE 802.3.
- Gigabit Ethernet: pjesërisht në përputhje

1000Base-LX 1310nm Single-Mode:



Në përputhje siç specifikohet në nenin 3 për 1000Base-LX

1000Base-SX 850nm Multi-Mode:

Në përputhje siç specifikohet në nenin 3 për 1000Base-SX

1000Base-LX40 1310nm Single-Mode:

Në përputhje siç specifikohet në nenin 3 për 1000Base-LX40

1000Base-ZX 1550nm Single-Mode:

Në përputhje siç specifikohet në nenin 3 për 1000Base-ZX

10G Ethernet: pjesërisht në përputhje

Për devijime shih:

4/155 19-CRX 110 01 Uen Rev C

10GBase-SR 850nm Multi-Mode:

Në përputhje siç specifikohet në nenin 4 për 10GBase-SR

10GBase-LR 1310nm Single-Mode:

Në përputhje siç specifikohet në nenin 4 për 10GBase-LR

10GBase-LRM 1310nm Multi-Mode:

Në përputhje siç specifikohet në nenin 4 për 10GBase-LRM

3. Ndërfaqet

E1 (2048 kbps)

- Niveli 1 i modelit OSI: Ndërfaqja A në përputhje me rekomandimin ITU-T G.703 në përputhje
- Elektrikisht në përputhje me 2048 kbit/s ndërfaqe.
- Sinkronizimi i inputit (TUB dhe TUB2-cards): Elektrikisht në përputhje.
- Niveli 2 i modelit OSI: struktura kornizë në përputhje me rekomandimin ITU-T G.704 në përputhje
- Në përputhje për strukturën themelore kornizë prej 2048 kbit/s që bartë nx64 kbit/s kanalej pa CAS.
- IP për SIP Nuk përdoret për momentin

4. Sinjalizimi nr. 7

- Versioni MTP: MTP i bardhë
- Q.701: në përputhje
- Grupet e lidhjeve nuk përkrahen.
- Libri i verdhë deri te libri i kuq dhe libri i kuq deri te libri i verdhë që ndërveprojnë nuk përkrahen.
- Q.703: në përputhje
- Q.704: në përputhje
- Alokimi ose rikonfigurimi automatik i pajisjeve sinjalizuese nuk përkrahet
- Kohëmatësi 24 nuk përdoret. Menaxhimi i trafikut sinjalizues fillon pa ndërprerje.
- Të gjitha ndryshimet emergjente në sistem trajtohen sikurse të ishin treguar nga një ndërprerje afatgjatë e procesorit.
- TFR nuk dërgohet asnjëherë por TFR hyrëse mund të transmetohet.
- T11 nuk implementohet.
- Q.707: në përputhje
- Versioni ISUP: ISUP V2 i bardhë, ETSI ETS 300 356 ose ITU-T Q.761 - Q.764 në përputhje




5. Pika kufitare

Pika kufitare është pika në fund të pajisjeve që lidhet me pajisjet e palës së kundërt.

Shtojca 2: Skema e pikës së lidhjes

Hierarkia e lidhjes së rrjetit të telefonisë mobile me operatorin përfitues

2.1 Adresa: IPKO Telecommunications LLC në Zonën Industriale, p.n. 10000 Prishtinë





Shtojca 3: Interkoneksioni i rrjetit duke marrë parasysh lokacionin e pikës së qasjes së sistemit të operatorit përfitues dhe të sistemit të IPKO-s

1. Kushtet e përgjithshme

Në pajtim me marrëveshjen për interkoneksionin e rrjetit, në lidhje me instalimin fizik të pajisjeve të komunikimit elektronik të operatorit përfitues dhe ekzekutimin e lidhjes në sistemin e IPKO-s, IPKO i ofron operatorëve përfitues këtë pikë të lidhjes:

- Komunikimi elektronik i operatorit përfitues dhe pajisjet tjera në ambientet e tij janë nën menaxhimin e operatorit përfitues, ndërsa IPKO do të ofrojë lidhje në mes të sistemeve të operatorit përfitues dhe IPKO-s. Kjo lidhje do të jetë në pronësinë dhe menaxhimin e IPKO-s së bashku me të gjitha komunikimet elektronike dhe të gjitha pajisjet tjera të siguruara nga IPKO në lokacionin e operatorit përfitues. Nëse është e nevojshme, operatori përfitues gjithashtu mund të marrë edhe bashkë-vendosjen, në bazë të një marrëveshjeje të shkruar.

2. Interkoneksioni i rrjetit në lokacionin e operatorit përfitues

2.1 Pika e terminimit të rrjetit në të cilën sistemi i operatorit përfituesit është i lidhur me sistemin e IPKO-s është në lokacionin e operatorit përfitues dhe paraqet de-limitimin e interkoneksionit të rrjetit. Linja e interkoneksionit nga IPKO për lokacionin e operatorit përfitues zbatohet nga IPKO, bazuar në kërkesën e operatorit përfitues. IPKO instalon pajisjet e duhura të transmetimit dhe panelin patch digjital dhe/ose optik në lokacionin e caktuar të operatorit përfitues dhe ky lokacion është i destinuar vetëm për IPKO-n, nëse plotësohen kushtet e përshtatshme minimale:

- zbatimi i përshtatshëm (i nevojshëm) i instalimit,
- dysheme antistatike,
- sistem i tokëzimit (së bashku me matjet e tokëzimit nga kompania e licencuar jo më të vjetra se 12 muaj),
- sigurimi i ndriçimit adekuat të dhomës, (500 lux 1 metër mbi dysheme),
- sigurimi = 48V rrymës së drejtpërdrejtë (ETS200 132-2) ose ~ furnizim me rryme alternative 230V,
- sigurimi furnizimit të pandërprerë me energji elektrike, duke përfshirë UPS dhe gjenerator




- elektrik me furnizim autonom me pajisjet e IPKO-s për minimum 24 orë,
- sigurimi i sistemit adekuat të ventilimit,
 - sigurimi i hyrjeve dhe daljeve të kërkuara.

2.2 Lidhje me kablllo të pajisjeve të operatorit përfitues zbatohet nga IPKO, në përputhje me karakteristikat teknike të dakorduara. Dy llojet e lidhjeve në dispozicion janë:

- kablllo me mbrojtje simetrike (120E)
- kablllo me fibra optik.

2.3 Operatori përfitues do t'i sigurojë qasje të papenguar dhe të përhershme IPKO-s në këto objekte për kërkesat e interkoneksionit, mirëmbajtjes, riparimeve dhe eliminimit të gabimeve. Nëse qasja nuk do të jetë e mundshme ose pengohet, pavarësisht nëse është faji i operatorit përfitues, ose faji i IPKO-s, IPKO nuk është përgjegjës për asnjë përgjegjësi lidhur me punën e deklaruar, dhe mundet, pas një paralajmërimi, edhe të anulojë marrëveshjen pa një periudhë të njoftimit paraprak.





Shtojca 4: Çmimet e shërbimeve

Çmimi për shërbimet e interkoneksionit ndërmjet operatorit përfitues dhe IPKO-s. Të gjitha zbatimet dhe qiratë faturohen nga dita e aktivizimit. Të gjitha çmimet janë në € (euro).

1. Instalimet e linjeve të komunikimit

Përshkrimi	Njësia	Çmimi pa TVSH
Instalimi i linkut 2 Mbit/s - E1	Tarifa për një herë	3,070.00 €
Zhvendosja e 2 Mbit/s – E1 nga një lokacion në tjetrin	Tarifa për një herë	1,000.00 €
Instalimi i 1Mbit/s IP kapacitet	Tarifa për një herë	100.00 €
Zhvendosja e 1Mbit/s IP Kapacitet nga një lokacion në tjetrin	Tarifa për një herë	100.00 €

2. Signalling

Përshkrimi	Njësia	Çmimi pa TVSH
Konfigurimi i linkut sinjalizues SS7	Tarifa për një herë	1,950.00 €
Konfigurimi i linkut sinjalizues SIP	Tarifa për një herë	1,560.00 €

3. Testimi bazuar në rekomandimet e ITU-T

Përshkrimi	Njësia	Çmimi pa TVSH
Testimi i interkoneksionit dhe sinjalizimit SS7	Tarifa për një herë	2,260.00 €
Testimi i interkoneksionit dhe sinjalizimit SIP	Tarifa për një herë	565.00 €

4. Mirëmbajtja e linjeve të komunikimit dhe sinjalizimit

Përshkrimi	Njësia	Çmimi pa TVSH
Mirëmbajtja e linkut 2Mbit/s - E1	Tarifë mujore	600.00 €
Mirëmbajtja e sinjalizimit SS7	Tarifë mujore	600.00 €



Mirëmbajtja e sinjalizimit SIP	Tarifë mujore	600.00 €
Mirëmbajtja e SIP për çdo linjë (concurrent call capacity)	Tarifë mujore	4.99 €

5. Ndryshim i konfigurimit të elementeve në rrjet

Përshkrimi	Njësia	Çmimi pa TVSH
Ndryshimi i konfigurimit	Çdo herë që kërkohet	100.00 €

6. Terminimi i thirrjeve në rrjetin e IPKO-s

Periudha	01 tetor 2020	01 janar 2021	01 Janar 2022
MTR në eurocent/min	1.046	0.946	0.846

7. Parametrat themelorë për vendosjen e infrastrukturës për interkonektim

Numri	Përshkrimi	Njësia matëse	Çmimi pa TVSH
1.	Analiza dhe mbledhja e të dhënave	m	0.50€
2.	Përgatitja e projektit	m	1.00 €
3.	Implementimi i FO në qytet	m	40.00€
4.	Implementimi i FO në vende rurale	m	20.00€
5.	Patch panel FO /port	Cope	50.00€
6.	Patch panel UTP / port	copë	20.00€
7.	FO converter	copë	60.00€
8.	UTP / shtrirja dhe instalimi	Cope	100.00€
9.	Patch cord / fije	copë	10.00€
10.	Splicing / fije	copë	10.00€
11.	OTDR matje /raporti	cope	200.00€
12.	Pranimi teknik / poroject	cope	300.00€

IPKO si dhe operatori përfitues kanë mundësi që pas shqyrtimit të çmimeve, pala më e lirë të bëjë instalimin për ofrim të intrekonsksionit, gjithashtu palët mund edhe të bëjnë ndarjen e kostove në proporcion për instalim.

Çmimet e shërbimeve përfshijnë vetëm terminimin e thirrjeve të përdoruesve fundorë nga sistemi i operatorit përfitues deri te përdoruesit fundorë të sistemit të IPKO-s. Çmimet e terminimit të thirrjeve me origjinë nga rrjetet e treta si dhe terminimi i thirrjeve me numra A me burim të panjohur, të pasigurt, të ndryshuar ose të paplotë, nuk janë subjekt i kësaj oferte për interkoneksion dhe do të ngarkohen sipas çmimeve komerciale.



Shtojca 5: Kërkesa standarde

IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC
Kërkesa standarde për shërbime të interkoneksionit

Emri i kompanisë:			
Numri i biznesit:		Numri fiskal:	
Drejtori i kompanisë:			
Adresa:		Tel: Fax:	
Kontakti administrativ:		Mob:	E-maili:
Kontakti teknik:		Mob:	E-maili:
Emri i bankës së kompanisë			
Llogaria bankare e kompanisë			

Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha dokumentet e kërkuara në përputhje me ofertën referencë.



_____	_____
Vendi	Përfaqësuesi
_____	_____
Data	Nënshkrimi dhe vula

Shtojca 6: Formulari i garancisë
Garanci pagese

Përfituesi: IPKO Telecommunications LLC, me adresë në rrugën "Zija Shemsiu" nr. 34, 10000 Prishtinë

Shuma: _____ euro (_____)
me numra me shkrim

Për llogari të parashtruesit të kërkesës: _____
Emri dhe adresa

Mbulimi: Detyrimet financiare të marrëveshjes së interkoneksionit me nr. _____
të datës _____

Në zbatim të marrëveshjes nr. _____ të datës _____ me objekt ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, banka _____ është në dijeni se për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga parashtruesi i kërkesës _____ me korrektësi, parashtruesi i kërkesës është i detyruar të dorëzojë një garanci financiare në një nga bankat komerciale në Kosovë në favor të IPKO Telecommunications LLC.

Me kërkesë të IPKO Telecommunications LLC, ne _____ marrim përsipër në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar që si kreditor kryesorë dhe jo vetëm si pale garantuese, sapo IPKO Telecommunications LLC të parashtrorë kërkesën e parë me shkrim, të paguajmë brenda 24 orëve çdo shumë të faturave (detyrimeve financiare) të papaguara nga parashtruesi i kërkesës të IPKO Telecommunications LLC ose/dhe tërë shumën totale të garancisë për çdo kërkesë të IPKO Telecommunications LLC në vlerë totale të garancionit _____ euro, pa kërkuar shpjegime dhe pa pasur asnjë lloj të drejte kundërshtimi nga ana jonë, duke përmendur në kërkesë mospërmbushjen e obligimeve kontraktuale të marrëveshjes së interkoneksionit.

Me këtë garanci sigurojmë IPKO Telecommunications LLC se nuk është nevoja t'i drejtoheni më pare ose t'i kërkohet miratim paraprak parashtruesit të kërkesës për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj. Shuma totale e kësaj garancie do të reduktohet në mënyrë automatike për çdo pagesë të kryer sipas kësaj garancie.



Kërkesa e juaj me shkrim, për pagesë duhet të paraqitet në _____ (Banka) në adresën e mëposhtme _____ (adresa e bankës që ka lëshuar garancionin). Kërkesa për pagesë të garancisë do të konsiderohet si e kryer në momentin që ne kemi kërkesën tuaj me shkrim për pagesë tek adresa jonë e sipërpërmendur. Deklarojmë gjithashtu, se në asnjë shtesë ose ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën ju mund të dakordoheni me parashtruesin e kërkesës, nuk na liron nga detyrimet e kësaj garancie. Kjo garanci është e vlefshme deri më _____ dhe skadon plotësisht dhe automatikisht nëse kërkesa e juaj për pagesë nuk është bërë në këtë date ose para kësaj date. Me kalimin e kësaj date, kjo garanci quhet e mbyllur dhe banka është e liruar nga çdo lloj detyrimi ndaj jush, në lidhje me këtë garanci. Kjo garanci është e lëshuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

_____ Banka (nënshkrimi dhe vula)

VËREJTJA 1: Në çmimet e lartpërmendura nuk janë llogaritur kostot e marrjes së licencave dhe lejeve nga autoritet përkatëse (qendrore dhe/ose komunale). Këto çmime do të kalkulohen në marrëveshje.

VËREJTJA 2: Të gjitha dhe çdo çmim që nuk është paraqitur dhe llogaritur në këtë ofertë do të rregullohen në një marrëveshje, varësisht nga kërkesa e parashtruar e operatorit përfitues.

VËREJTJA 3: Të gjitha çështjet tjetra juridike që nuk rregullohen me këtë ofertë referencë do të jenë objekt i marrëveshjes së përbashkët në marrëveshjen me shkrim që do të nënshkruhet nga të dyja palët.

VËREJTJA 4: Kjo ofertë mund të ndryshohet në çdo kohë në bazë të nevojave dhe detyrimeve të IPKO Telecommunications LLC.